



**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË**

**Prishtinë, 10 mars 2023**

Ftesë për shfaqje të interesit për pjesëmarrje në Konferencën shkencore me temën:  
**STUDIMET PËR SHQIPTARËT NË BRITANINË E MADHE DHE NË VENDET E EUROPËS  
VERIORE**

Kolege dhe Kolegë të nderuar,

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) bashkë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë kanë vendosur që me 26 dhe 27 tetor 2023 të organizojnë konferencën shkencore me temën “Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore”.

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë ka mbajtur deri tash katër konferenca shkencore ndërkombëtare në të cilat janë vështruar zhvillimet e studimeve albanistike, në vitin 2015 “Studimet albanistike në Amerikë” (materialet u botuan tek ASHAK më 2016); në vitin 2017 “Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht” (materialet u botuan më 2018 tek ASHAK), në vitin 2019 u mbajt konferenca e tretë e kësaj serie me temën “Studimet albanistike në Itali” (materialet u botuan më 2020 tek ASHAK) dhe në vitin 2021 “Studimet dhe shkrimet për shqiptarët në Francë” (materialet u botuan më 2022 tek ASHAK). Për të gjitha këto konferenca pati interesim dhe pjesëmarrje të gjerë.

Në vijim të kësaj përvoje Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut vendosi të organizojë një konferencë me tematikën “Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore”, ku po ashtu kemi të bëjmë me një traditë të gjatë interesimesh për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe.

Interesi i autorëve britanikë për botën shqiptare shtyhet në kohë qysh në fillim të shekullit XVIII. Historiani anglez Edward Gibbon e kishte përshkruar Shqipërinë si "një tokë brenda vizionit të Italisë dhe më pak e njohur se brendësia e Amerikës". Në atë periudhë, njëri prej udhëtarëve më të njohur që kishte shkelur nëpër tokat shqiptare ishte Lord Byron, ndërkaq udhëtimi dhe përshtypjet e tij zgjuan kureshtjen e shumë njerëzve të tjerë, të cilët gjatë shek. XIX vizituan Ballkanin dhe trevat shqiptare. Ndër personalitete britanike që kanë udhëtuar nëpër trevat shqiptare në Ballkan dhe kanë lënë dokumente të shkruara për këto vizita janë: William Martin Leake, Lordi John Hobhouse dhe Edward Lear. Në shekullin XX, udhëtarja më e njohur që kishte vizituar trevat shqiptare ishte Edith Durham, e cila, duke kuptuar thelbin e rendit fisnor shoqëror e juridik të zonave malsore veriore kishte përshkruar në mnënyrë mjeshtërore tiparet, zakonet dhe doket e shqiptarëve në Ballkan. Më tej, në gjysmën e parë të shekullit XX, Stuart E. Mann shkroi tekste me rëndësi për gjuhën shqipe në

fushat e fonologjisë dhe të historisë së gjuhës, botoi një gramatikë, fjalorin historik, trajtesa historike-antologjike për letërsinë, fjalorin shqip-anglisht, gramatikën historike të shqipes, etj. Në vitet '70 të shekullit të kaluar, një autor tjetër britanik erdhi me studime me rëndësi për gjendjen e shqipes dhe të varieteteve të saj dialektore e historike. Peter Trudgill solli studime sociolinguistike me interes për gjendjen e dialekteve arvanitase në Greqi dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me identitetin e arvanitasve. Në tri dekadat e fundit është i njohur kontributi i historianit britanik Noel Malcolm, studimet e të cilit hodhën dritë në shumë aspekte me rëndësi për historinë e Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Sot në Britaninë e Madhe ka një gjallërim të interesit për studimet shqiptare, si në fushat e historisë ashtu edhe në fushat e filologjisë, përfshirë në kohët tona edhe interesin për kulturën dhe letërsinë. Nuk ka dyshim se gjallërimi i diasporës shqiptare atje luan një rol. Në përgjithësi, autorët britanikë tash e tre shekuj kanë dhënë një kontribut të çmuar për studimet në fushën e historisë, të kulturës dhe të gjuhës shqipe dhe në këtë mënyrë kanë bërë që shqiptarët të njihen më mirë në botë për traditat, zakonet e gjuhën e tyre.

Interesimet për shqiptarët, për gjuhën, kulturën dhe historinë e tyre, nuk kanë munguar as tek autorët që vijnë nga vendet skandinave dhe nga Europa Veriore në përgjithësi. Në këto hapësira ka pasur më shumë interes për gjuhën shqipe në kuadër të studimeve krahasuese indoeuropiane, e më vonë edhe për shqipen e sotme, në radhë të parë, pra, për studimet gjuhësore. Janë të njohura qysh në fillimet e tyre interesimet e studiuesve Rasmus Rask e Sophus Bugge për historinë e krahasuar dhe për etimologjitë indoeuropiane. Në fushat e studimit të historisë së gjuhës shqipe shquhen ato të indoeuropeistit të madh Holger Pedersen, që shkëlqeu në albanistikë në dekadën e parë të sh. XX, duke na lënë sprovë me rëndësi për shpjegimet e ndryshme të historisë gramatikore të shqipes dhe për vendosjen e saj në raportet me gjuhët e tjera indoeuropiane. Rëndësi të madhe për studimet shqiptare ka vjelja nga ana e tij e materialeve nga terreni në hapësirat e Çamërisë dhe përshkrimi i saktë i realitetit gjuhësor atje. Ndihtesat e tij për studimet e historisë së gjuhës shqipe dhe për vendosjen e linjave drejtuese në këto studime shquhen në linjën maestrale të tyre në pjesën e dytë të sh. XIX-pjesën e parë të sh. XX, Franz Bopp, Gustav Meyer, Holger Pedersen, Norbert Jokl. Janë shquar po ashtu studimet e romanistit e ballkanologut Kristian Sandfeld për raportet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit, pak më vonë të sllavistit e rumanistit Gunnar Svane në fushën e filologjisë e të shqipes së autorëve të vjetër, po edhe të raporteve të shqipes me gjuhët sllave, etj. Në ato hapësira ka pasur dhe interesa për studimin e aspekteve të tjera të kulturës, të letrave e me këtë edhe të miqësive me shqiptarët në sh. XX. Është shquar në këtë drejtim depërtimi në studimin e raporteve të realitetit shoqëror shqiptar i studiueses dhe mikes së madhe shqiptare me fat tragjik të antropologes norvegjeze Berit Becker në fund të sh. XX. Sot në ato vende vepron dhe diaspora kulturalisht e gjallë shqiptare nga Kosova e Shqipëria. Interesimet për gjuhën dhe botën shqiptare kanë qenë të rëndësishme edhe në Holandë dhe vendet e tjera të Europës Veriore, sidomos ndër ballkanologë, sllavistë e romanistë dhe tash vonë ndër historianë, studiues të kulturës e të religjionit dhe gjuhëtarë që janë marrë me Ballkanin.

Në kohët tona ka gjithnjë e më shumë interes për intensifikimin e këtyre kontakteve të botës intelektuale shqiptare gjithandej (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, diasporë) me zhvillimet studimore në Britaninë e Madhe dhe në Europën Veriore në përgjithësi.

Duke e vlerësuar lart tërë këtë traditë studimesh për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në Europën Veriore, propozojmë të mbahet një konferencë shkencore me këtë temë me synimin që të bëhet një pasqyrë sadopak e plotë për studimet dhe shkrimet për botën shqiptare në ato hapësira dhe me këtë edhe t'u jepet një shtysë zhvillimeve të mëtejme dhe përdegezimit të këtyre kontakteve në të gjitha rrafshet e veprimtarisë kulturore-intelektuale. Në relacionet e ndërlidhjeve dhe të pranisë aktuale të diasporës shqiptare në ato hapësira impakti që vjen nga ato horizonte ka rëndësi jo vetëm për zhvillimet e përgjithshme të studimeve për gjuhën dhe kulturën shqiptare, po edhe për zhvillimet e mëtejme brenda kësaj bashkësie në horizontet e reja globale.

Konferenca do të mbahet më 26-27 tetor 2023 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në Prishtinë.

Gjuhë komunikimi në konferencë do të jenë shqipja dhe anglishtja. Materialet e Konferencës do të botohen në vëllim të veçantë.

Për referim në Konferencë për secilin pjesëmarrës parashikohen 15 minuta dhe do të ketë dhe diskutime 5 minuta pas çdo kumtese.

Shpenzimet e qëndrimit në Prishtinë gjatë ditëve të konferencës i heq ASHAK-u.

Luten të gjithë të interesuarit që deri me 15 korrik 2023 të shfaqin interesin për pjesëmarrje, duke dërguar titullin e kumtesës që duan të paraqesin dhe një abstrakt të shkurtë, në mënyrë që organizuesi të jetë në gjendje t'i bëjë planifikimet me kohë. Paraqitja për pjesëmarrje në konferencë është e hapur.

Për organizimin e konferencës Akademia ka ngritur një Këshill organizues me këtë përbërje:

akademik Rexhep Ismajli, kryetar  
akademik Sabri Hamiti, anëtar  
akademike Floresha Dado, anëtare  
akademike e asocuar Kristina Jorgaqi, anëtare  
akademik i asocuar Gëzim Hoxha, anëtar dhe  
anëtari korrespondent i ASHAK-ut Shkumbin Munishi, sekretar i Këshillit.

Në emër të Këshillit organizues

Akademik Rexhep Ismajli



Për arsye praktike komunikimi me pjesëmarrësit e konferencës do të zhvillohet përmes anëtarit korrespondent të ASHAK-ut, Prof. Dr. Shkumbin Munishit, dhe shërbimit profesional të ASHAK-ut, znj. Dafina Kavaja.

Email:

[konferenca@ashak.org](mailto:konferenca@ashak.org)

[rexhepismajli@ashak.org](mailto:rexhepismajli@ashak.org)

[flora.dado@yahoo.com](mailto:flora.dado@yahoo.com)

[jorgaqi62@yahoo.com](mailto:jorgaqi62@yahoo.com)

[ghoxha2000@yahoo.com](mailto:ghoxha2000@yahoo.com)

[shkumbin.munishi@uni-pr.edu](mailto:shkumbin.munishi@uni-pr.edu)

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA**

**Pristina, March 10, 2023**

Invitation to express interest in participating in the scientific conference on the topic:

**STUDIES ON ALBANIANS IN GREAT BRITAIN AND NORTHERN EUROPEAN  
COUNTRIES**

Dear Colleagues and Colleagues,

The Kosova Academy of Sciences and Arts (Section of Linguistics and Literature) jointly with the Academy of Sciences of Albania has decided to organize a scientific conference on the topic "Studies on Albanians in Great Britain and in the countries of Northern Europe" on October 26 and 27, 2023.

The Section of Linguistics and Literature of the Kosova Academy of Sciences and Arts (KASA) in cooperation with the Academy of Sciences of Albania (ASA), has so far held four international scientific conferences in which the developments of the studies on Albanian overseas: in 2015 "Albanian studies in America" (the papers were published by KASA in 2016); in 2017 "Albanian studies in German-speaking countries" (the papers were published in 2018 by KASA); in 2019 the third conference of this series was held with the topic "Albanian studies in Italy" (the papers were published in 2020 by KASA) and in 2021 "Studies and writings about Albanians in France" (the papers were published in 2022 by KASA). There was wide interest and participation in all those conferences.

Following this experience, the Linguistics and Literature Section of KASA decided to organize a conference on the topic "Studies on Albanians in Great Britain and in the countries of Northern Europe ", where we are also dealing with a long tradition of interest in Albanians and the Albanian language.

British authors' interest in the Albanian world dates back to the beginning of the 18th century. The English historian Edward Gibbon had described Albania as "a land within the vision of Italy and less known than the interior of America". In that period, one of the most famous travelers who had set foot through the Albanian lands was Lord Byron, while his journey and impressions aroused the curiosity of many other people, who visited the Balkans and the Albanian lands during the XIX century. Among the British notables who traveled through the Albanian lands in the Balkans and left written documents about those visits are: William Martin Leake, Lord John Hobhouse, and Edward Lear. In the 20th century, the most famous traveler who had visited the Albanian lands was Edith Durham, who, understanding the essence of the tribal, social, and legal order of the northern mountainous areas, had masterfully described the features and customs of the Albanians in the Balkans. Further, during the first half of the 20th century, Stuart E. Mann wrote important texts on the Albanian language in the fields of phonology and the history of the language, published a grammar, historical dictionary, historical-anthological treatise on literature, Albanian-English dictionary, the historical grammar of Albanian, etc. During the 70s of the last century, Peter Trudgill brought interesting sociolinguistic studies on the state of Arvanite dialects in Greece and other issues related to Arvanite identity. The contribution of the British historian Noel Malcolm during the last three decades has been well known. His studies shed light on many important aspects of the history of Kosova and Albanians in general. Today in Great Britain there is a revival of interest in Albanian studies, both in the fields of history and in the fields of philology, including actually the interest in culture and literature. There is no doubt that the revitalization of the Albanian diaspora there plays a role. In general, British authors for three centuries now have made a valuable contribution to studies

in the field of Albanian history, culture, and language and in this way have made Albanians better known in the world for their traditions, customs, and language.

The interest in the Albanians, their language, culture, and history, has not been absent even among the authors coming from the Scandinavian countries and Northern Europe in general. In these spaces, there has been more interest in the Albanian language within the framework of comparative Indo-European studies, and later also in today's Albanian, in the first place, therefore, for linguistic studies. The interests of researchers Rasmus Rask and Sophus Bugge in historic-comparative studies and Indo-European etymologies are known from the beginning. In the fields of studying the history of the Albanian language, those of the great Indo-Europeanist Holger Pedersen, who excelled in Albanian studies in the first decade of the XX, have left important evidence for different explanations of the historical grammar of Albanian and its placement in relations with other Indo-European languages. Of great importance for Albanian studies is his collection of field materials in the spaces of Chameria and their accurate description of the linguistic reality. His contributions to the studies of the history of the Albanian language and the establishment of the guiding lines in these studies stand out in their masterly line in the second part of the XIX - the first part of XX c., Franz Bopp, Gustav Meyer, Holger Pedersen, Norbert Jokl. The studies of the specialist on Roman languages and Balkanologist Kristian Sandfeld on the relations of Albanian with other languages of the Balkans, later by the specialist on Slavic and Romanian Gunnar Svane in the field of philology and the Albanian of old authors, as well as the relations of Albanian with Slavic languages, etc. In those spaces, there were also interests in the study of other aspects of culture, of letters, and with this also of friendships with Albanians in the United States. In this regard, the penetration into the study of reports of the Albanian social reality of the researcher and great Albanian friend with the tragic fate of the Norwegian anthropologist Berit Becker at the end of the XX c. Today, the Albanian language and world have attracted interest in the Netherlands and other Northern European countries, especially among Balkanologists, Slavists, and Romanists, and more recently among historians, cultural and religious researchers, and linguists who have dealt with the Balkans.

In our times, there is more and more interest in intensifying these contacts of the Albanian intellectual world everywhere (Albania, Kosova, Macedonia, diaspora) with academic developments in Great Britain and Northern Europe in general.

Appreciating this whole tradition of studies about the Albanian language and Albanians in Great Britain and Northern Europe, we propose to hold a scientific conference on this topic to make a somewhat complete overview of studies and writings about the Albanian world in those spaces and with this to give an impetus to further developments and the branching of these contacts in all levels of cultural-intellectual activity. In the relations of connections and the current presence of the Albanian diaspora in those spaces, the impact that comes from those horizons is important not only for the general developments of studies on the Albanian language and culture but also for further developments within this community in the new global horizons.

The conference will be held on October 26-27, 2023 on the premises of the Kosova Academy of Sciences and Arts in Pristina.

The languages of communication at the conference will be Albanian and English. The materials of the Conference will be published in a separate volume.

For reference at the Conference, 15 minutes are provided for each participant and there will be 5 minutes of discussion after each statement.

The expenses of staying in Pristina during the days of the conference are covered by KASA.

All interested parties are requested to show their interest in participating by July 15, 2023, by sending the title of the paper they want to present and a short abstract, so that the organizer can make plans in time. The application for participation in the conference is open.

For the organization of the conference, the Academy has set up an organizing Council with the following composition:

Academician Rexhep Ismajli, chairman  
Academician Sabri Hamiti, member  
Academician Floresha Dado, member  
Associate Academician Kristina Jorgaqi, member  
Associate Academician Gëzim Hoxha, member and  
ASAK Associate Member Shkumbin Munishi, Secretary of the Council.

On behalf of the organizing council

Academician Rexhep Ismajli



For practical reasons, the communication with the participants of the conference will take place through the corresponding member of ASHAK, Prof. Dr. Shkumbin Munishi, and the professional service of ASHAK, Ms. Dafina Kavaja.

Email:

[konferenca@ashak.org](mailto:konferenca@ashak.org)

[rexhepismajli@ashak.org](mailto:rexhepismajli@ashak.org)

[flora.dado@yahoo.com](mailto:flora.dado@yahoo.com)

[jorgaqi62@yahoo.com](mailto:jorgaqi62@yahoo.com)

[ghoxha2000@yahoo.com](mailto:ghoxha2000@yahoo.com)

[shkumbin.munishi@uni-pr.edu](mailto:shkumbin.munishi@uni-pr.edu)